



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1449, datë 12.11. 2010

Për

“Fillimin e procedimit administrative për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve INFO-Telecom sh.p.k dhe AMC sh.a”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 12.11.2010, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brëndshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis sipërmarrësve INFO-Telecom sh.p.k dhe AMC sh.a

BAZA LIGJORE:

1. Neni 49, neni 50 pika 1 dhe neni 60 e vijues, pika te ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9918*);
2. Neni 46 e vijues të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Rregullore “Për procedurat e zgjidhjes se mosmarrëveshjeve”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 1296, datë 11.06.2010;
4. Rregullore “Për Aksesin dhe Interkoneksionin, miratuar VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar;

5. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP (**Rregullorja e Brendshme**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Shkresa e INFO-Telecom e datës 13.01.2010, ku kërkohet takim me Departamentin e Interkonksionit të AMC për implementimin e marrëveshjes së interkoneksionit;
2. Shkresa e INFO-Telecom me nr. 09031001 ML datë 09.03.2010 drejtuar AMC;
3. Shkresa e AMC nr. 1391/1 datë 11.03.2010 drejtuar INFO-Telecom;
4. Shkrese e INFO-Telecom nr. 16031001ML datë 16.03.2010 drejtuar AMC;
5. Shkrese e INFO-Telecom nr. 13041002 ML, datë 13.04.2010 “Në vijim të Tonës nr. 16031001ML Prot, datë 16.03.2010”;
6. Shkresë e INFO-Telecom nr. 27081002 ML prot, datë 27.08.2010, drejtuar AMC, për dijeni AKEP “Në vijim të komunikimeve tona të datës 13 Janar, 9 Mars, 16 Mars, 13 Prill 2010 në lidhje me Marrëveshjen e Interkoneksionit”;
7. Shkresë e INFO-Telecom nr. 18101001/1ML prot, datë 18.10.2010 drejtuar AMC “Kërkese për realizimin e një takimi për të diskutuar mbi Marrëveshjen e interkoneksionit dhe të negociojmë mbi tarifën e trafikut kombëtar dhe ndërkombëtar për terminimin e thirrjeve në rrjetin e AMC”;
8. Shkresa e INFO-Telecom sh.p.k nr. 28101001 ML, datë 28.10.2010 drejtuar AKEP për dijeni AMC sh.a, “Kërkesë për ndërhyrje Administrative për zgjidhje mosmarrëveshje ndërmjet INFO-Telecom sh.p.k dhe AMC sh.a;
9. Deklaratë e datës 28.10.2010, nga administratorja Znj. Anisa Skëndaj.
 - Relacion shpjegues mbi projektvendimin (**Relacioni**);si dhe duke iu referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipercituar,

V Ë R E N:

1. Sipërmarrësi “INFO-Telecom” sh.p.k me shkresën nr. 28101001ML prot, datë 28.10.2010 në përputhje me pikën 1, neni 50 të ligjit nr.9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në përputhje me rregulloren e mosmarrëveshjeve miratuar me VKD nr. 1296 date 11.06.2010 pas perfundimit të afateve ligjore të parashikuara për lidhjen e marrëveshjes së interkoneksionit ka paraqitur ankim administrativ pranë AKEP;
2. INFO-Telecom më 13.01.2010 i dergon një shkresë AMC dhe nëpërmjet saj jep një përshkrim të përgjithshëm të kompanisë për shërbimet që parashikon të ofrojë në tregun e telekomunikacioneve.
3. Info Telecom më datë 09.03.2010 dërgon një dosje në AMC kërkon përsëri lidhjen e MI me AMC, me qëllim ofrimin e shërbimeve publike fikse, si dhe shërbimin e tranzitimit të

- thirrjeve kombëtare dhe ndërkombëtare. Info telecom pretendon se kërkesa shoqërohej me gjithë dokumentacionin që parashikohet në Aneksin nr IV pika 4.1.2 të RIO të AMC;
4. AMC me datë 11.03.2010 i dëgon një shkresë INFO-Telecom nëpërmjet së cilës Kërkon:
 - a. Gjithë dokumentacionin paraprak si në Aneksi IV të RIO të AMC dhe dokumentacionin që mungonte në mënyrë që të planifikonte një zgjidhje teknike për implementimin e Interkoneksionit me INFO-Telecom ;
 - b. AMC informon INFO-Telecom mbi Vlerën e garancisë financiare që INFO-Telecom duhej të vinte në dispozicion të AMC në përputhje me trafikun e parashikuar nga INFO-Telecom;
 - c. AMC shprehet se e ka shqyrtuar kërkesën e INFO-Telecom për Interkoneksion por AMC e konsideron të pamundur lidhjen e qarqeve të interkoneksionit për momentin duke parashtruar pamundësi teknike, situatë e cila mund të zgjasë disa muaj;
 - d. Së fundmi AMC i sugjeron Info Telecom të interkonektonte rrjetin e vet me atë të AMC në mënyrë tranzit nëpërmjet Albtelecom;
 5. INFO-Telecom më datë 16.03.2010 kthen përgjigje shkresës së AMC duke përmbushur kërkesën AMC sipas gërmës a) më sipër cituar, dhe konfirmon se ishte dakord me vlerën e garancisë financiare të përlllogaritur nga AMC dhe se ishte gati ta vinte atë në dispozicion të AMC, në pritje për të projektuar një zgjidhje optimale për implementimin e interkoneksionit me Info Telecom;
 6. INFO-Telecom më datë 13.04.2010, duke marrë parasysh që AMC për sa më sipër nuk kishte kthyer ende një përgjigje i drejtohet përsëri për të kërkuar ofertën mbi shërbimet e lidhjes sipas gërmës e) të pikës 1 të Aneksit II dhe gërmës f) të pikës 1 të Aneksit III të RIOs;
 7. INFO-Telecom në mungesë të përgjigjes nga AMC ka tentuar të kontaktojë përsëri me AMC për të diskutuar edhe mbi ndryshimet e fundit në kuadrin rregullator të AKEP, në mënyrë të veçantë mbi ofrimin e shërbimit të terminimit të thirrjeve në rrjetin e AMC me origjinë kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe negocimin e tarifës së terminimit;
 8. Për sa më sipër INFO-Telecom në ankimin e saj kërkon:

AMC të përmbush detyrimin ligjor për:

 - a. Lidhjen e Marrëveshjes së Interkoneksionit me INFO-Telecom sh.p.k brënda afateve kohore të përcaktuara në kuadrin rregullator të AKEP dhe legjislacionit në fuqi;
 - b. Specifikimin e afatit kohor të saktë në të cilin kërkesa për lidhjen dhe implementimin e Marrëveshjes së Interkoneksionit do të përmbushet;
 - c. Dhënien e informacionit në lidhje me preventivin e punimeve (koston) për shërbimin e lidhjes në rastin e bashkëvendosjes në ambjentet e INFO-Telecom

Si dhe,

 - d. Ndërhyrjen e menjehershme nga AKEP më qëllim që AMC të lidhë dhe implementojë sa më shpejt MI me Info Telecom, për realizimin e shërbimeve

zanore të terminimit të thirrjeve hyrëse kombëtare në AMC dhe anasjelltas si dhe terminimin e thirrjeve ndërkombëtare në AMC.

9. AKEP për sa më sipër konsideron se, AMC si sipërmarrës me fuqi të ndjeshme në treg ka detyrimin për terminimin e thirrjeve në rrjetet celulare dhe t'u ofroje palëve të treta akses dhe interkoneksion në rrjet dhe elementet e tij. Gjithashtu në zbatim edhe të nenit 50 të ligjit 9918 datë 19.05.2008 zgjidhja e mosmarrëveshjes mund të kryhet në bazë të kërkesës së një sipërmarrësi apo me iniciativën e AKEP,

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 46 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brëndshme.

V E N D O S:

1. Të fillojë procedimim administrativ, për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së interkoneksionit midis Albanian Mobile Communications sh.a dhe Info Telecom sh.p.k.;
2. Të ngrihet komisioni për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me përbërje si:
 - Jetmir Braha Kryetar
 - Florida Çela Anëtar
 - Xhenisa Nela Anëtar
 - Ded Jakaj Anëtar
 - Esmaralda Dervishi Anëtar
3. Të njoftohen palët e interesuara "INFO-Telecom" sh.p.k dhe "AMC" sh.a për fillimin e procedimit administrativ;
4. Palët të depozitojnë pretendimet e tyre me shkrim brenda 15 ditëve nga marrja e vendimit;
5. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP: www.akep.al

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARË:

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURCE**